

LD العالم اطباء منظمة LÄKARE I VÄRLDEN MEDICI DEL MON
MÉDICOS DO MUNDO MÉDICOS DEL MUNDO 世界の医療団
世界医生组织 DOCTORS OF THE WORLD منظمة أطباء العالم
DOKTERS VAN DE WERELD MÉDICOS DO MUNDO
गै डॉक्टर MÉDECINS DU MONDE 世界医生组织 DOCTORS
I DEL MONDO ΓΙΑΤΡΟΙ ΤΟΥ ΚΟΣΜΟΥ DOKTERS VAN DE
WERELD दुनिया के डॉक्टर MÉDECINS DU MONDE 世界医生组织 DO

In association with



BritishRedCross



VAKSINIMI KUNDËR KORONAVIRUSIT (COVID-19) ANGLI, SKOCI DHE UELLS

Vaksinat kundër koronavirusit (COVID-19) janë të sigurta dhe kanë efikasitet të lartë. Ato ju ofrojnë mbrojtjen më të mirë kundër koronavirusit.

Versioni i parë (i përditësuar më 03.03.2021)

SHQIP | ALBANIAN



Tabela e përmbajtjes

KUJT DUHET T'I INJEKTOHET VAKSINA KUNDËR COVID-19.....	2
SI INJEKTOHET VAKSINA KUNDËR COVID-19.....	3
SI TA MERRNI VAKSINËN KUNDËR COVID-19.....	4
SA TË SIGURTA JANË VAKSINAT KUNDËR COVID-19.....	7
SA E EFEKTSHME ËSHTË VAKSINA KUNDËR COVID-19.....	7
EFEKTET ANËSORE TË VAKSINËS KUNDËR COVID-19.....	7
PËRBËRËSIT E VAKSINËS KUNDËR COVID-19.....	8
MË SHUMË INFORMACIONE.....	8

KUSH MUND TA MARRË VAKSINËN KUNDËR COVID-19

Vaksinat kundër COVID-19 të ofruara nga Shërbimi Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor (NHS) do të jepen falas për të gjithë të rriturit në Angli, Skoci dhe Uells, pavarësisht statusit të tyre të emigracionit. Kjo përfshin njerëzit që nuk përfitojnë nga fondet publike (NRPF). NHS-ja aktualisht po ua ofron vaksinën kundër COVID-19 personave që janë më të rrezikuar nga koronavirusi.

Vaksinat po shpërndahen në qendrat vendore të vaksinimit që menaxhohen nga mjekët e familjes (GP) dhe në qendrat më të mëdha të vaksinimit.

NHS-ja do t'i vaksinojë njerëzit sipas shkallës së rrezikut shëndetësor, kryesisht bazuar nga gjendja ekzistuese mjekësore dhe grupmoshat, nga të moshuarit tek të rinjtë. Disa njerëz janë shumë më të rrezikuar, sesa të tjerët nga komplikacionet serioze të COVID-19.

Vaksina po u ofrohet:

- Personave të moshës 55 vjeç e lart
- Personave që janë më të rrezikuar nga koronavirusi (ata me shqetësime shëndetësore afatgjata)
- Personave që janë më të rrezikuar për shkak të komplikacioneve nga koronavirusi si pasojë e problemeve ekzistuese shëndetësore (të tilla si SPOK, astma, probleme të zemrës, sëmundje të veshkave ose mëlçisë, diabeti dhe probleme të tjera shëndetësore afatgjata)
- Personave që jetojnë ose punojnë në shtëpinë e kujdesit
- Punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe social
- Personave me aftësi të kufizuar në të mësuar
- Personat që kanë të drejtën të përfitojnë nga Ndihma Financiare e Kujdestarit

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar synon t'u ofrojë të gjithë të rriturve dozën e parë të vaksinës deri në fund të korrikut.

Angli: [Lexoni informacionin më të fundit mbi vaksinimin kundër COVID-19 për të moshuarit](#)

Skoci: [Lexoni informacionin më të fundit mbi vaksinimin kundër COVID-19 për të rriturit](#)

Uells: [Lexoni informacionin më të fundit mbi vaksinimin kundër COVID-19](#)

Nëse nuk e keni përfituar të drejtën për t'u vaksinuar ende

Prisni që t'ju kontaktojnë. NHS-ja do t'ju njoftojë se kur është radha juaj për t'u vaksinuar

Angli: [Lexoni informacionin më të fundit mbi kualifikimin për marrjen e vaksinës kundër COVID-19 dhe furnizimin me vakcina](#)

A është vakcina e përsht'atshme për të gjithë?

Nuk ka asnjë provë se vakcina kundër COVID-19 është e pasigurt nëse jeni shtatzëne, por nevojiten më shumë prova para se t'u ofrohet në mënyrë të mirëqenë.

Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin përditëson këshilla nëse duhet apo jo të vaksinoheni në rast shtatzënie dhe:

- nëse jeni të rrezikuar për t'u infektuar me koronavirus për shkak të vendit ku punoni
- keni një problem shëndetësor nga i cili jeni më shumë të rrezikuar nga komplikacionet për shkak të koronavirusit.

Ju nuk keni nevojë të shmangni shtatzëninë pas vaksinimit. Vaksinat nuk përmbajnë ndonjë virus ekzistues që mund t'ju infektojnë juve ose foshnjën tuaj me COVID-19. Nuk ka asnjë provë që vaksinat COVID-19 do të ndikojnë në fertilitet.

Ju mund të vaksinoheni kundër COVID-19 nëse jeni duke ushqyer fëmijën me gji. Para se të vaksinoheni, flisni me një ekspert të kujdesit shëndetësor. Ata do të diskutojnë me ju rreth dobive dhe rreziqeve.

Angli: [Lexoni këshillat më të fundit për vaksinat kundër COVID-19 nëse jeni shtatzënë, mund të mbeteni shtatzënë ose jeni duke ushqyer me gji](#)

Skoci: [Lexoni këshillat më të fundit për vaksinat kundër COVID-19 nëse jeni shtatzënë, mund të mbeteni shtatzënë ose jeni duke ushqyer me gji](#)

Uells: [Lexoni këshillat më të fundit për vaksinat kundër COVID-19 nëse jeni shtatzënë, mund të mbeteni shtatzënë ose jeni duke ushqyer me gji](#)

Ju nuk duhet të vaksinoheni kundër COVID-19 nëse keni pasur ndonjëherë reaksion të rëndë alergjik (përfshirë anafilaksinë) pas një doze të mëparshme nga e njëjta vaksinë ose ndonjë nga përbërësit e vaksinës.

Personat që kanë imunitet të dobët dhe janë të infektuar me HIV (pavarësisht nga treguesi i CD4) duhet të vaksinohen.

Njerëzit që vuajnë nga tromboza ose çrregullime të gjakderdhjes mund të vaksinohen, por mund të kenë nevojë që të konsultohen me ofruesin e kujdesit shëndetësor për t'u siguruar që të jepet në kohën e duhur gjatë trajtimit.

SI JEPET VAKSINA KUNDËR COVID-19

Vaksinat kundër COVID-19 merren të gjitha me anë të injeksionit në pjesën e sipërme të krahut. Ato ofrohen në dy doza. Ju do të merrni dozën e dytë 3 deri në 12 javë pasi të keni marrë dozën e parë.

Kur të merrni dozën e parë të vaksinës ju do të pajiseni me një kartë të vogël me të dhënat e vaksinës. Ju duhet ta ruani këtë kartë. Nëse duhet të merrni dozën tuaj të dytë të vaksinës në një qendër tjetër vaksinimi, karta do të shërbejë për të marrën llojin e duhur të vaksinës.

SI TA MERRNI VAKSINËN KUNDËR COVID-19

Vaksinat kundër COVID-19 të ofruara nga NHS-ja do të jepen falas për të gjithë të rriturit në Mbretërinë e Bashkuar, pavarësisht statusit të tyre të emigracionit.

Është më lehtë ta merrni vaksinën nëse jeni regjistruar në një nga klinikat e mjekut të familjes (GP). Kjo do të bëjë të mundur që të pajiseni me një numër nga NHS-ja dhe mund të rezervoni një takim për vaksinimin kur të ju vijë radha (bazuar në moshën ose kushtet klinike). Regjistrimi në një GP do të thotë që ju mund të përdorni edhe shërbime të tjera shëndetësore dhe të kujdesit të përgjithshëm.

Një GP është një mjek i familjes. Në [Angli](#), [Skoci](#) dhe [Uells](#) të gjithë mund të regjistrohen në GP dhe të marrin falas shërbimet e kujdesit parësor, pavarësisht nga statusi i imigracionit.

Nëse nuk jeni regjistruar ende në një GP ju duhet të gjeni një GP vendore dhe të regjistroheni tani, edhe nëse ju nuk e keni përfituar të drejtën për t'u vaksinuar. Ju mund të gjeni një GP pranë zonës ku jetoni, duke përdorur faqen e internetit të NHS- së për [Anglinë](#), [Skocinë](#) ose [Uellsin](#) ose mund të telefononi GP-në tuaj vendore dhe të kërkonte të regjistroheni si pacient.

Klinikat e GP-së mund të regjistrojnë vetëm ata personat që jetojnë në atë zonë. Nëse jetoni jashtë zonës së klinikës së GP-së, atëherë do t'ju duhet të gjeni një GP tjetër më afër zonës ku jetoni.

Ju do të duhet të plotësoni një formular për t'u regjistruar në një GP. Ju mund të kontrolloni faqen e internetit të klinikës së GP-së për të parë nëse mund të regjistroheni online. Ju duhet të kërkonte të regjistroheni si një pacient i përhershëm (jo si i përkohshëm). Ju mund të kërkonte ndihmë nga klinika e GP-së për plotësimin e formularit nëse keni nevojë për të.

Çfarë dokumentesh duhen për t'u regjistruar pranë një qendre shëndetësore

Disa klinika mund t'ju kërkojnë të siguronit dokumente, të tilla si vërtetim adrese, dokument identifikimi ose dokument të statusit të emigracionit ose një numër të NHS-së për t'u regjistruar si pacient, por ata nuk duhet të refuzojnë t'ju regjistrojnë nëse nuk mund t'i siguronit këto dokumente.

Nëse nuk mund t'i siguronit këto dokumente, duhet të thoni se nuk i keni ato, por që duhet të jetoni brenda zonës së klinikës dhe do të donit të regjistroheshit në GP si pacient.

Nëse hasni probleme gjatë regjistrimit në GP, atëherë burimet e mëposhtme mund t'ju vijnë në ndihmë. Nëse jeni duke u regjistruar përmes internetit dhe ju kërkohen dokumente, ju mund t'ia dërgoni burimet klinikës së GP-së me email:

- **NHS-ja e Anglisë** ka nxjerrë [karta të verdha për të ndihmuar ata që janë pa dokumente që të regjistrohen në një GP në Angli](#). Kartën mund ta paraqisni pranë recepcionit të GP-së kur shkoni për t'u regjistruar. Ju mund të merrni një kartë të verdhë nga shoqatat bamirëse vendore, bankat e ushqimeve, shoqata bamirëse vendore "Healthwatch" ose nga "Mjekët e Botës" (Doctors of the World).

- **Qeveria skoceze** ka lëshuar udhëzime për GP-të në Skoci që specifikojnë: “Nuk nevojitet asnjë dokument për t’u regjistruar në një GP. Pamundësia e një pacienti për të siguruar dokument identifikimi ose vërtetim adrese nuk është shkak i arsyeshëm për të refuzuar ose vonuar regjistrimin e një pacienti”.
- **Udhëzimet e Shoqatës Britanike të Shëndetësisë** për mjekët në Angli, Skoci, Uells dhe Irlandën e Veriut shprehin se, “Nëse një pacient nuk është në gjendje të sigurojë dokumente identifikimi, këto nuk janë shkaqe të arsyeshme për të refuzuar regjistrimin e tij/saj”.

Nëse një GP jua ka refuzuar regjistrimin, atëherë pacientët në Angli mund të telefonojnë në nr. 0300 311 2233. Pacientët në Skoci dhe Uells duhet të kontaktojnë me Bordin Shëndetësor lokal. Pacientët gjithashtu mund të kontaktojnë “Mjekët e Botës” (Doctors of the World) në nr. 0808 1647 686 (numër telefoni pa pagesë) për ndihmë për t’u regjistruar në një GP.

Nëse jeni i pastrehë

Ju mund të regjistroheni në një GP nëse nuk keni një adresë fikse. Ju duhet t’i shpjegoni klinikës së GP-së se nuk keni një adresë fikse, por që po banoni në zonën që mbulon ajo GP dhe do të dëshironit të regjistroheshit si pacient. Ju mund të përdorni një adresë të përkohshme, e cila mund të jetë adresa e një miku ose e një qendre ditore dhe mjeku i familjes prapë mund t’ju regjistrojë pa një adresë.

Ju duhet të siguroheni që GP-ja t’ju kontaktojë me telefon nëse e shohin të nevojshme (për shembull, për t’ju dhënë përgjigjet e analizave).

Nëse jeni duke qëndruar në një strehim për azilkërkuesit

Nëse si azilkërkues jeni duke qëndruar në një qendër strehimi të siguruar nga Zyra e Punëve të Brendshme (Home Office) ose një qendër strehimi të përkohshme në rast të një emergjence civile, siç është hoteli, duhet të përdorni adresën e këtij strehimi kur regjistroheni në GP dhe të thoni se nuk keni dokumente që vërtetojnë adresën, sepse po qëndroni në një strehim të siguruar nga Zyra e Punëve të Brendshme. Nëse një GP nuk pranon t’ju regjistrojë, atëherë duhet të flisni me ofruesin tuaj të strehimit ose telefononi "Ndihmë për Emigrantët" (Migrant Help) në nr. 0808 8010 503 (numër telefoni pa pagesë).

Nëse zbuloni se Zyra e Punëve të Brendshme (Home Office) do t’ju transferojë në një qendër strehim të re, duhet të nxitoni që ta merrni vaksinën kundër COVID-19 para se të transferoheni. Dozën e dytë të vaksinës mund ta merrni në një qendër vaksinimi pranë vendbanimit tuaj të ri.

Ju duhet ta ruani me kujdes kartën e vogël që ju është dhënë në takimin e marrjes së dozës së parë dhe ta keni me vete në takimin e marrjes së dozës së dytë në mënyrë që qendra e vaksinimit të sigurohet që të merrni llojin e duhur të vaksinës.

Caktimi i një takimi për vaksinimin

Angli

Takimet për vaksinimin mund t’i rezervoni online nëse plotësoni ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

- jeni 55 vjeç e lart
- jeni shumë të rrezikuar nga koronavirusi (personat me probleme shëndetësore afatgjata)

- jeni më të rrezikuar për shkak të komplikacioneve nga koronavirusi si pasojë e problemeve ekzistuese shëndetësore (të tilla si SPOK, astma, probleme të zemrës, sëmundje të veshkave ose mëlçisë, diabeti dhe probleme të tjera shëndetësore afatgjata)
- jeni punonjës i kujdesit shëndetësor në vijën e parë
- jeni punonjës i kujdesit social në vijën e parë
- jeni person me aftësi të kufizuara në të mësuar
- jeni person që ka fituar të drejtën të përfitojë nga [Ndhma Financiare e Kujdestarit](#)

Ju mund t'i rezervoni takimet në një qendër më të madhe vaksinimi që ofron vaksinat kundër COVID-19. Ju nuk keni nevojë të prisni që të kontaktoheni nga NHS-ja.

[Ju mund të lini takimin tuaj për vaksinimin kundër COVID-19 përmes internetit.](#)

Skoci

Ju do të merrni një ftesë ose një telefonatë me të dhënat e takimit tuaj. Nëse do të paraqiteni në takim, nuk keni nevojë të bëni asgjë për të konfirmuar që do të paraqiteni. Ju mund të [ricaktoni ose anuloni takimin tuaj](#) nëse nuk mund të paraqiteni, në mënyrë që takimi të mund t'i rezervohet një pacienti tjetër për t'u vaksinuar.

Uells

Kur të jetë radha juaj për të marrë vaksinën, ju do të kontaktoheni direkt nga NHS-ja. Ju mund të kontaktoheni ose me telefon ose me postë.

A do të informohet Zyra e Punëve të Brendshme (Home Office) nëse vaksinohem

Informacioni juaj nuk do t'i përcillet Departamentit të Emigracionit pranë Zyrës së Punëve të Brendshme (Home Office) kur merrni ndonjë shërbim nga NHS-ja që ofrohet falas për të gjithë, pavarësisht statusit tuaj të emigracionit. Kjo përfshin shërbimet e GP-së dhe shërbimet e testimit, trajtimit dhe vaksinimit kundër COVID-19.

Juve nuk duhet t'ju kërkohet të vërtetoni statusin tuaj të imigracionit kur regjistroheni në një GP ose kur rezervoni një takim për vaksinimin kundër COVID-19.

[Disa shërbime spitalore dhe vendore të NHS-së](#) që nuk kanë të bëjnë me testimin, trajtimin ose vaksinimin kundër koronavirusit, nuk janë falas për njerëzit pa status të rregullt të emigracionit. Këto shërbime mund të përcjellin vetëm këto informacione rreth jush, siç është emri, adresa dhe data e lindjes, tek Departamenti i Emigracionit të Zyrës së Punëve të Brendshme (Home Office). Kjo bëhet për të konfirmuar statusin tuaj aktual të emigracionit ose për të njoftuar nëse keni tarifa të papaguara për kujdesin shëndetësor. Por informacioni në lidhje me shëndetin tuaj nuk do të jepet.

Në rrethana kur ka shqetësime për sigurinë e individëve ose publikun, shërbimeve të NHS-së mund t'u kërkohet që informacionet e pacientit t'i përcillen policisë, gjykatave dhe departamenteve qeveritare.

SA TË SIGURTA JANË VAKSINAT KUNDËR COVID-19

Vaksinat e aprovuara për përdorim në Mbretërinë e Bashkuar janë në përputhje me standardet më të larta të sigurisë, cilësisë dhe efikasitetit të përcaktuara nga Agjencia e Pavarur Rregullatore e Barnave dhe Produkteve Mjekësore (MHRA).

Çdo vaksinë kundër koronavirusit që aprovohet duhet të kalojë nëpër të gjitha provat klinike dhe kontrollet e sigurisë ashtu siç vepohet me të gjitha ilaçet e tjera të licencuara. MHRA-ja vepron sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë.

Të gjitha vaksinat janë testuar në 15,000 deri në 50,000 njerëz në të gjithë botën. Ato janë testuar tek burrat dhe gratë, tek njerëzit me prejardhje të ndryshme etnike dhe tek të gjitha moshat ndërmjet 18-84 vjeç. Studimet do të vazhdojnë edhe gjatë shpërndarjes së vaksinave për të parë se sa efikasitet kanë ato në parandalimin e infeksionit ose mbartjen e virusit që mund të prekë të tjerët dhe për ta shtrirë përdorimin e tyre edhe tek fëmijët.

Deri më ani, miliona njerëz e kanë marrë vaksinën kundër COVID-19 dhe raportimet rreth efekteve të rënda anësore, të tilla si reaksione alergjike, kanë qenë shumë të rralla. Nuk është raportuar asnjë ndërlikim afatgjatë.

Për të mësuar më shumë rreth vaksinave të miratuara në Mbretërinë e Bashkuar, vizitoni faqen e internetit:

- [GOV.UK: Vaksina Pfizer/BioNTech kundër COVID-19 e miratuar nga MHRA-ja \(Vetëm në gjuhën angleze\)](#)
- [GOV.UK: Vaksina Oxford/AstraZeneca kundër COVID-19 e miratuar nga MHRA-ja \(Vetëm në gjuhën angleze\)](#)
- [GOV.UK: Vaksina Moderna kundër COVID-19 e miratuar nga MHRA-ja \(Vetëm në gjuhën angleze\)](#)

SA EFIKASITET KA VAKSINA KUNDËR COVID-19

Doza e parë e secilës prej vaksinave kundër COVID-19 duhet t'ju ofrojë mbrojtje të mirë nga koronavirusi. Por duhet t'i merrni të dyja dozat e vaksinës për të pasur një mbrojtje më të qëndrueshme. Ekziston një mundësi që prapë të prekeni ose ta përhapni koronavirusin edhe nëse jeni vaksinuar. Kjo do të thotë se është e rëndësishme të:

- vazhdoni të respektoni [udhëzimet për distancimin social](#)
- nëse keni mundësi, përdorni diçka që mbulon hundën dhe gojën në vende ku është e vështirë të ruani distancën nga njerëzit e tjerë

EFEKTET ANËSORE TË VAKSINËS KUNDËR COVID-19

Shumë prej efekteve anësore të vaksinës kundër COVID-19 janë të lehta dhe nuk duhet të zgjasin më shumë se 2-3 ditë, të tilla si:

- krah i pezmatuar në pjesën e injektimit
- ndjesi lodhjeje
- dhimbje koke
- ndjesi dhimbjeje
- të ndjerit i sëmurë

- temperaturë ose ethe

Nëse keni nevojë, mund të merrni qetësues për dhimbjet, siç është paracetamoli.

Nëse keni temperaturë të lartë që zgjat më shumë se 48 orë mund të jeni prekur nga koronavirusi ose ndonjë infektion tjetër. Kolla dhe humbja e nuhatjes ose shijes nuk janë efekt anësor i vaksinës, kështu që nëse keni këto simptoma duhet të bëni një test për koronavirusin duke [vizituar faqen e internetit](#).

Nëse simptomat tuaja përkeqësohen, zgjasin për më shumë se 48 orë ose jeni të shqetësuar, telefononi GP-në tuaj ndërmjet orës 08:00 dhe 18:30 ose në momente të tjera telefononi në nr. 111 (ky është numër pa pagesë). Ju mund të kërkonti një përkthyes në gjuhën tuaj duke iu përgjigjur vazhdimisht të gjitha pyetjeve me “Yes”.

Reaksionet alergjike

Tregojini stafit të kujdesit shëndetësor para se të vaksinoheni nëse keni pasur ndonjëherë reaksion të rëndë alergjik. Ju nuk duhet ta merrni vaksinën kundër COVID-19 nëse keni pasur ndonjëherë reaksion të rëndë alergjik (përfshirë anafilaksinë) ndaj:

- një dozë të mëparshme nga e njëjta vaksinë
- njërës prej përbërësve të vaksinës

Reaksionet e rënda alergjike janë të rralla. Nëse keni ndonjë reaksion ndaj vaksinës, kjo zakonisht ndodh brenda disa minutave. Stafit dhe vullnetarët në qendrat e vaksinimit janë trajnuar për t'u kujdesur për reaksionet alergjike dhe për t'i trajtuar ato menjëherë.

Ju mund të raportoni çdo efekt anësor duke përdorur [skemën e sigurisë së Kartonit të Verdhë për koronavirusin](#).

PËRBËRËSIT E VAKSINËS KUNDËR COVID-19

Vaksinat e aprovuara kundër [COVID-19](#) nuk përmbajnë ndonjë produkt shtazor ose vezë.

Këshilli Mjekësor i Bashkësisë Islame Britanike [rekomandon vaksinimin kundër COVID 19](#). Kisha katolike ka deklaruar se [vaksinimi kundër COVID 19 kundër COVID-19 është moralisht e pranueshme](#).

MË SHUMË INFORMACIONE

Mjekët e Botës (Doctors of World): [Informacione klinike dhe të përkthyer mbi COVID-19](#)

Kryqi i Kuq Britanik: [Vaksinat kundër COVID-19: çfarë duhet të dini](#)

NHS Angli: [Vaksina kundër koronavirusit \(COVID-19\)](#)

NHS Inform: [Vaksina kundër koronavirusit \(COVID-19\)](#)

Shëndeti Publik Uells: [Informacion mbi vaksinën kundër COVID-19](#)